



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



THEMARI

Pranuar - Primi/jona Më/Dona	25-09-2020		
Nr./i organit Org.broj	Numri/Droj	Shifra Prilog	Vlera Vendos*
02-035/02-911			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 dhe nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 19.2 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për varreza, mirëmbajtjen e tyre dhe shërbimet e varrimit në territorin e Komunës së Vitisë nr 01-013/1962 të datës 30.12.2014, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M  
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ  
6,890.00€ KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË VITI

Neni 1.

Kryetari i Komunës së Vitisë, ndan mjetet financiare në shumë 6,890.00€ ( gjashtë mijë e tetëqindë e nëntëdhjetë euro) Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në emër të shërbimeve të varrimit të persona të vdekur në Komunën e Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në llogarinë 17-02-001600083743.

Neni 2.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është regjistri i shërbimeve të varrimit i Këshillit të Bashkësisë Islame i qytetarëve të vdekur në Komunën e Vitisë prej 04.04.2020 deri më datën 19.07.2020 për 53 persona të vdekur ( nga numri 1 deri 53 i faturës). Numri i faturës nr 157/20 të datës 21.07.2020 me nr. të protokollit 06-320/04-21063.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2020 nga Sherbimet Sociale Kategoria për Subvencione të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti: 25.06.2020

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

